



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 42, Datë 21,12,2016

**PËR CAKTIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMET E RASTIT TË UDHËTARËVE  
BRENDA VENDIT (LIBRI I UDHËTIMIT)**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21/12/2016 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 30 pika 7, neni 34 pika 4 si dhe neni 38 pika 1 dhe pika 2 germat c dhe ç, Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" si dhe Udhëzimit Nr.20, datë 10.10.2007 " Për modelet e liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" :

**VENDOSI :**

1. Të miratojë tarifën prej 500 (pesëqind) lekë për të gjitha shërbimet e rastit 1(një) ditore brenda vendit, për lëvizjen e udhëtarëve për nevoja të ndryshme familjare, turistike, mësimore etj. Subjektet që autorizohen për veprimtari të tilla duhet që së bashku me kërkesën të paraqesin të gjitha dokumentat e duhura dhe liçencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
2. Pagesa për marrjen e këtij shërbimi do të kryhet pranë çdo banke të nivelit të dytë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 78, pika 3.

  
KRYETARI I KËSHILLIT QARKUT  
SADRIT DANAJ

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlore me Nr . Prot, date . .201

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site : [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 600